


DITARI MUJOR

SHTATOR 2024



MUAJI I MONUMENTEVE HISTORIKE

Ekspozita "Muaji i Monumenteve Historike" është një iniciativë e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, e cila synon të promovojë dhe të rrisë ndër-gjegjësimin për pasurinë kulturore dhe historike të Shqipërisë. E zhvilluar në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit, ekspozita është shfaqur në disa qytete kyçe të vendit, duke përfshirë Beratin, Gjirokastrën, Shkodrën dhe Elbasanin.

Ekspozita përmban materiale grafike dhe fotografi historike të monumenteve të klasifikuara si "Monumente Kulture" nga arkivat e IKTK-së, të cilat ilustrojnë punën dhe përkushtimin për ruajtjen e këtyre pasurive ndër vite. Panelet e ekspozitës shoqërohen me përshkrime historike të shkurtëra, dhe vizitorët kanë mundësinë të marrin kartolina me imazhe të monumenteve të shoqëruara me përshkrime në shqip dhe anglisht, për të mbajtur si kujtim.

Qëllimi i ekspozitës është të sjellë në vëmendje rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe rolin e saj në identitetin kombëtar, si dhe të inkurajojë mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve historike për brezat e ardhshëm.

BERAT



Ekspozita në kuadër të "Muajit të Monumenteve Historike", e mbajtur në qytetin e Beratit, u përqendrua në promovimin e monumenteve kulturore dhe trashëgimisë historike të Shqipërisë. Berati, një nga qytetet më të vjetra dhe me rëndësi të madhe kulturore në vend, ofroi një kontekst të pasur për këtë ekspozitë.


Ekspozita shfaq material grafik të monumenteve të klasifikuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, përfshirë ato të Beratit, i njohur për arkitekturën e tij të ruajtur mirë dhe statusin si një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Vizitorët patën mundësinë të eksplorojnë histori dhe fakte interesante për këto monumente përmes paneleve informuese dhe kartolinave të personalizuar, duke përfutur një kuptim më të thellë të trashëgimisë kombëtare.



GJIROKASTËR

Ekspozita "Muaji i Monumenteve Historike", e mbajtur në Kalanë e Gjirokastrës, u përqendrua në pasurimin e njohurive për trashëgiminë kulturore dhe historike të Shqipërisë. Kalaja e Gjirokastrës, një nga monumentet më të rëndësishme dhe simbolike të vendit, ofroi një sfond unik për zhvillimin e kësaj ekspozite.



Vizitorët patën mundësinë të eksplorojnë dokumente dhe materiale grafike që përfaqësojnë monumentet kulturore në të gjithë Shqipërinë, të mbledhura nga arkivat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Kjo ekspozitë ftoi vizitorët të zbulojnë historitë e pasura që qëndrojnë pas këtyre monumenteve, duke përfshirë edhe elementët unike të arkitekturës dhe kulturës që i bëjnë këto vende kaq të veçanta.



SHKODËR



Ekspozita "Muaji i Monumenteve Historike" në Kalanë e Shkodrës ishte një ngjarje e veçantë që solli në vëmendje trashëgiminë e pasur kulturore të këtij qyteti dhe më gjerë. Duke prezantuar materiale grafike nga monumentet më të rëndësishme të Shqipërisë, ekspozita ftoi vizitorët të eksplorojnë historinë dhe arkitekturën e tyre.

Ekspozita gjithashtu prezantoi një sërë kartolinash me përshkrime të monumenteve në shqip dhe anglisht, të cilat u shpërndanë si suvenire për turistët. Këto materiale, të nxjerra nga arkivi i Institutit, përfaqësojnë një përmbledhje të punës të IKTK-së që nga themelimi i tij. Ndërthurja e historisë me aspektin edukativ u bë një nga qëllimet kryesore të ekspozitës, duke ofruar një përvojë unike për vizitorët dhe nxitur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë sonë kulturore.



ELBASAN

Ekspozita "Muaji i Monumenteve Historike" arriti kulmin e saj në qytetin e Elbasanit, në ambientet e Muzeut Etnografik. Ekspozita përfshiu materiale grafike dhe fotografi të monumenteve historike nga e gjithë vendi, duke përfshirë kështjella, kisha, dhe site të rëndësishme arkeologjike, të cilat pasqyrojnë historinë e pasur të Shqipërisë.



Ekspozita në Elbasan u veçua për përfshirjen e nxënësve dhe vizitorëve vendas e të huaj, duke krijuar një atmosferë ndërvepruese dhe edukative. Vizitorët patën mundësinë të njihen me materiale arkivore të IKTK-së, të cilat përfaqësojnë një përpjekje shumëvjeçare për të dokumentuar dhe mbrojtur monumentet e kulturës shqiptare. Kartolinat e shpërndara me përshkrime të monumenteve, si dhe aktivitetet me nxënësit, bënë që ky event të mbahet mend si një hap i rëndësishëm në ndërgjegjësimin dhe promovimin e trashëgimisë sonë të përbashkët.




REVISTA MONUMENTET



Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), prej vitesh boton në mënyrë periodike Revistën "Monumentet". Numri i parë i kësaj reviste është botuar në vitin 1971. Vit pas viti këto botime kanë shpalosur vlerat e trashëgimisë kulturore, nga emrat më të shquar të kësaj fushe, duke bërë të mundur njohjen e këtyre vlerave të cilat janë përcjellë dhe janë mirëmbajtur me fanatizëm brez pas brezi.

IKTK dhuroi botime ndër vite të Revistës "Monumentet", Revista "Arkeologjia" etj., për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (DPA), me qëllim pasurimin e arkivit të saj dhe për të kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.



PROJEKTE NË VAZHDIM

Vijon puna për zbatimin e projektit **"Përmirësim i turizmit potencial kulturor, nëpërmjet ndërhyrjes në sitet e trashëgimisë kulturore në Voskopojë"**, për ndërhyrjet konservuese/restauruese në katër objekte unike të trashëgimisë tonë kulturore në Voskopojë dhe Vithkuq, përkatësisht në:

- Kisha e Shën Prodhromit,
- Kisha e Shën Marisë,
- Kisha e Shën Mëhillit,
- Kisha e Shën Pjetrit dhe Pavlit.



Punimet për konservimin e pikturave murale, të cilat po kryhen nga restauratori Adrian Çene dhe ekipi i tij, konsistojnë kryesisht në:

- Ringjithjen e shtresave pregtitore,
- Konsolidimin e pelikulit piktorik,
- Pastrimin nga depozitimet,
- Mbushjet e çarjeve.

Specialistët e Sektorit të Artit në IKTK po ndjekin në vijimësi nga afër zbatimin dhe ecurinë e këtyre ndërhyrjeve.

Financues i projektit: Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe zbatues "Leon Konstruksion".

ANTIGONEA, GJIROKASTRA DHE LUGINA E DRINOS

Në kuadër të "Ditëve Europiane të Trashëgimisë Kulturore" dhe "Ditës Kombëtare të Trashëgimisë", në Kalanë e Gjirokastrës u zhvillua konferenca shkencore **"Antigonea, Gjiro-kastra dhe Lugina e Drinos midis Arkeologjisë dhe Zhvillimit të Turizmit"**, ku në përfundim të misionit Italo-Shqiptar rreth gërmimeve arkeologjike në "Parkun Arkeologjik Antigone" dhe përgjatë luginës së Drinos u paraqitën rezultatet e këtyre hulumtimeve.



Të pranishëm në këtë konferencë ishin:

- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore z.Sokol Ismaili,
- Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë z.Flamur Golemi,
- Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë z.Ardis Duka,
- Drejtori i Institutit Italian të Kulturës z.Alessandro Ruggera,
- Konsulli Italian në Vlorë z.Achille Provenzano,
- Konsulli Italian në Gjirokastrë z.Teodor Bilushi,
- Prof. Roberto Perna dhe Sabina Veseli, si dhe arkeologë të misionit Italo-Shqiptar.

PROJEKTE RESTAURIMI

Përfundoi ndërhyrja konservuese/restauruese në pikturën murale të **Kishës së T'Shëlbuemit** në Rubik. Falë programit të **#EU4Culture** dhe punës së restauratores Edlira Çausi dhe ekipit të saj, gjatë këtyre muajve u kryen punime konservuese/restauruese duke i dhënë një pamje tjetër të gjithë ambientit në pjesën lindore të kësaj kishe.



Specialistët e Sektorit të Veprave të Artit në IKTK mbikqyrën nga afër ecurinë e këtyre punimeve. Risi e ndërhyrjeve ishte zbulimi i fragmenteve të pikturës murale në faqet jugore dhe veriore duke plotësuar në mënyrë harmonike të gjithë bërthamën e kishës së vjetër.



GËRMIME NË SHËNMRI, TIRANË

Arkeologët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK-së kanë realizuar me sukses një gërmim shpëtimi në fshatin Shënmri, ku u zbulua një varrezë që daton në dy periudha historike të rëndësishme: periudhën helenistike dhe mesjetare. Ky zbulim unik hedh dritë mbi historinë dhe jetën e banorëve të lashtë të kësaj zone.



Gjatë gërmimeve, arkeologët kanë zbuluar struktura funerare që përmbanin enë qeramike, stoli prej argjendi, bronzi, hekuri dhe qelqi, si dhe armë dhe objekte personale.

Këto gjetje unike ofrojnë mundësi të mëdha për të studiuar mënyrën e jetesës dhe zakonet e të dy periudhave. Stolitë e zbuluara në varret mesjetare ngjajnë me ato të kulturës Arbërore të gjetura më parë në Koman, Krujë, Lezhë dhe Përmet, duke treguar për një shpërndarje të gjerë kulturore në Shqipëri.

Për herë të parë gjetjet e kulturës Arbërore zbulohen në zonën e Tiranës, duke i shtuar vlerë të jashtëzakonshme trashëgimisë kulturore të kryeqytetit. Ekspertët e IKTK-së do të vazhdojnë të dokumentojnë dhe analizojnë zbulimet, ndërsa hapi i ardhshëm do të jetë lokalizimi i vendbanimeve që duhet të jenë afër varrezës së zbuluar.

DITA KOMBËTARE E TRASHËGIMISË KULTURORE



Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore festohet më 29 shtator dhe ka për qëllim të promovojë dhe mbrojë pasuritë e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Kjo ditë përqendrohet në ndërgjegjësimin e publikut për vlerat historike, artistike dhe arkeologjike të vendit, duke nxitur respektin dhe kujdesin për monumentet dhe traditat kulturore.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) luan një rol kyç në këtë drejtim, duke monitoruar dhe mbrojtur monumentet e kulturës, organizuar projekte restaurimi dhe promovuar trashëgiminë kulturore përmes ekspozitave, konferencave dhe aktiviteteve të tjera edukative.



KALAJA E TIRANËS

Në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, në Kalanë e Tiranës u zhvillua një ekspozitë e veçantë, e cila përqendroi vëmendjen në monumentet dhe objektet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare. Kjo ekspozitë prezantoi materiale të vlefshme nga arkivat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, duke pasqyruar historinë e pasur të monumenteve kulturore në Shqipëri. Vizitorët patën mundësinë të shohin nga afër disa prej thesareve të trashëgimisë sonë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të këtyre vlerave për brezat e ardhshëm.

